

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**  
**STUDIMET POSTDIPLOMIKE- Master**  
**DEPARTAMENTI CIVIL DHE PRONËSOR**



***“KUFIZIMET E PRONËSISË ME FOKUS NË IMISIONET”***

Mentori:  
Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

Kandidatja:  
Elsa Hoxha

*Prishtinë, 2021*

## **I. Abstrakt**

Zhvillimet e përgjithshme shoqërore dhe ekonomike të cilat i kanë paraprirë botës mbarë kanë krijuar nevojën që të tregohet një kujdes i veçantë ndaj aspektit pronësor dhe çështjeve që lidhen me pronën dhe kufizimet gjatë shfrytëzimit të saj.

Në mënyrë që gjatë ushtrimit të së drejtës në pronë nga titullari ligjor i saj, shfrytëzimi i pronës të bëhet në mënyrë sa më racionale duke mos shkaktuar dëme personave të tjerë në ushtrimin e të drejtave të tyre, sot janë prezente kufizimet e pronësisë.

Qëllimi kryesor i këtij studimi përbënë identifikimin dhe rëndësinë e kufizimeve pronësore me theks apo fokus të veçantë në imisionet. Fokusi është në imisionet sepse, kufizimet e kësaj natyre janë aktuale në ditët e sotme dhe natyrisht studimet apo trajtimet e tyre janë më se të mirëpritura.

Hulumtimi i takon formës shpjeguese sepse, do të tregojë se si ka ardhë deri te domosdoshmëria e të ekzistuarit të kufizimeve pronësore në lidhje me imisionet ku edhe do të identifikojë ato, si dhe do të jap arsyet pse duhet shkuar drejt fuqizimit të kufizimeve të pronësisë

**Fjalët kyçe: Prona, E drejta pronësore, Kufizimet, Imisionet, Titullari, etj.**